



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe**  
**EC MA NDRYSHE**

*2 mars 2015, Prizren*

**Reagim**

**Të zgjedhurit dhe të emëruarit në Mamushë të heqin dorë nga gjuha joparlamentare**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës online të Komunës së Mamushës, EC Ma Ndryshe ka përcjellë seancën e rregullt të Kuvendit Komunal të Mamushës.

Në këtë seancë përplasjet verbale ndërmjet këshilltarëve të KK-së nga opozita dhe zyrtarëve të ekzekutivit janë karakterizuar me gjuhë joparlamentare, ndërkohë që ka pas tentativë edhe për kacafytje fizike, gjë që është evituar me ndërhyrjen e të pranishmeve në sallën e KK-së së Mamushës.

Duke marrë parasysh rrjedhën e këtij incidenti, EC Ma Ndryshe përmes këtij reagimi shpreh shqetësimin për nivelin e komunikimit mes anëtarëve të KK-së dhe zyrtarëve të ekzekutivit, të cilët parimisht duhet të jenë në shërbim të publikut dhe me respekt të trajtojnë institucionin më të lartë komunal.

Përplasja me gjuhë fyese dhe denigruese nga të dyja palët nuk i bën nder askujt dhe në të njëjtën kohë ul besimin e publikut në raport me të zgjedhurit dhe të emëruarit e pushtetit lokal. Përdorimi i gjuhës fyese, personalizimi i çështjeve në seanca të KK-së, por edhe ndërhyrja e pavend e zyrtarëve të ekzekutivit çon kah shkelja e parimeve bazë të parlamentarizmit.

EC Ma Ndryshe duke shprehur shqetësimin e saj të thellë për nivelin shumë të ultë të komunikimit gjatë seancës së KK-së i bën thirrje të gjithë akterëve të pushtetit lokal në Mamushë: për respektim të institucionit, i cili duhet të jetë në shërbim të interesave të qytetarëve; për maturi në vendimmarrje; respektim të parimeve të demokracisë dhe sjellje konform ligjeve dhe normave juridike, me mirësjellje reciproke.

EC Ma Ndryshe edhe njëherë përkujton se KK-ja është organ më i lartë vendimmarrës në komunë, që duhet të mbikëqyr punën e ekzekutivit dhe se debati në të duhet të jetë gjithmonë në kuadër të suazave të gjuhës parlamentare.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së Komunës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese

OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*